



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.10.2023

Nr: 786

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË KUKËS, QARKU KUKËS Z. ALBERT BISLIM HALILAJ, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET E PJESSHME TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Sot më datë 4.10.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e pjesshme, të datës 24 Shtator 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 186, datë 11.8.2023, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës", u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Data: 4.10.2023 Nr: 786
Ora: 12:30



"Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e pjesshme të datës 24 Shtator 2023"

Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, me vendimin nr. 17, datë 26.9.2023, ka shpallur fitues z. Albert Bislim Halilaj, si Kryetar i Bashkisë Kukës, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, z. Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI